



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

Treguesit Statistikor të Tregut të Komunikimeve Elektronike

Tremujori IV 2022

Data e Publikimit: _____._____.2023

INDEKSI I PËRMBAJTJES

I.	HYRJE	3
II.	TENDENCAT KRYESORE.....	4
III.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET CELULARE.....	6
IV.	TREGUESIT E TREGUT TË SHËRBIMEVE NGA RRJETET FIKSE.....	12

INDEKSI I TABELAVE

TABELA 3.1 : NUMRI I PAJTIMTARËVE/PËRDORUESVE CELULARË SIPAS KATEGORIVE	6
TABELA 3.2: NUMRI I PAJTIMTARËVE TË SHËRBIMEVE CELULARË (KARTA SIM) SIPAS OPERATORËVE.....	7
TABELA 3.3: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE..	7
TABELA 3.3/1: PËRQINDJA E PËRDORUESVE AKTIVË ME PARAPAGIM TË SHËRBIMEVE CELULARE SIPAS OPERATORËVE	8
TABELA 3.4: NUMRI I PËRDORUESVE AKTIVË TË TELEFONISË CELULARE SIPAS OPERATORËVE ...	8
TABELA 3.5: NUMRI I PËRDORUESVE TË AKSES BROADBAND NË RRJETET 3G/4G SIPAS OPERATORËVE.....	9
TABELA 3.6: VOLUMI TOTAL I THIRRJEVE, SMS-VE, TË DHËNA DHE PËRDORIMI MESATAR MUJOR	9
TABELA 3.7: STRUKTURA E THIRRJEVE DALËSE CELULARE TË ORIGINUAR BREND A VENDIT SIPA DESTINACIONIT	11
TABELA 4.1 : NUMRI I LINJAVE TË PAJTIMTARËVE TË TELEFONISË FIKSE	12
TABELA 4.2 : NUMRI I PAJTIMTARËVE ME AKSES BROADBAND NGA RRJETET FIKSE	12
TABELA 4.3 : NUMRI I PAJTIMTARËVE QË KANË AKSES NË SHËRBIME TË INTEGRUARA	13

I. Hyrje

Bazuar në përcaktimet e Ligjit 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, dhe Rregullores nr.12, datë 07.04.2010, “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” e ndryshuar, AKEP mbledh të dhëna periodike statistikore nga sipërmarrësit ofrues të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike në Shqipëri.

AKEP ka filluar të publikojë periodikisht të dhëna dhe tregues statistikorë të tregut të komunikimeve elektronike prej muajit Prill 2009 në faqen web www.akep.al. Periodiciteti i publikimeve dhe treguesit e publikuar kanë evoluar nga raportime vjetore dhe gjashtëmujore në raportime vjetore dhe tremujore duke filluar nga Tremujori 4 2014.

Sipërmarrësit e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrim ligjor të dërgojnë në AKEP, të raportojnë të dhëna periodike rreth aktivitetit të tyre sipas formularëve përkatës që janë pjesë e Rregullores Nr.12. Informacioni i kërkuar nga AKEP nëpërmjet formularëve të Rregullores shërben për përbushjen e detyrave funksionale të AKEP, ndër të tjera edhe për publikimin e treguesve për publikun e gjërë nëpërmjet raporteve periodike që evidentojnë treguesit kryesorë të zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike.

AKEP publikon treguesit kryesorë të tregut të komunikimeve elektronike duke marrë në konsideratë si natyrën konfidenciale të një sërë treguesve të raportuar nga sipërmarrësit edhe interesat e publikut për të krijuar një treg të hapur dhe konkurruesh. Për këtë arsyesh shumë tregues paraqiten të agreguar për tregun në tërësi dhe jo sipas operatorëve, ndërsa disa tregues parqiten edhe sipas operatorëve.

AKEP mundohet që të dhënat e publikuara të janë të plota dhe të sakta për të garantuar një pasqyrim të drejtë të situatës dhe tendencave të tregut të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Megjithatë, në disa raste informacioni i mbledhur mund të mos jetë i plotë për shkak se jo të gjithë sipërmarrësit raportojnë në kohë dhe me cilësinë e duhur të dhënat e kërkuar.

AKEP për të rritur plotësinë dhe saktësinë e informacionit të mbledhur dhe të publikuar bashkëpunon me operatorët gjatë procesit të raportimit të të dhënave nëpërmjet komunikimit në modulin on-line, e-mail dhe telefon, si dhe përdor mekanizmat ligjore të detyrimit të raportimit të të dhënave si inspektimi në terren dhe/ose vendosjen e sanksioneve ligjore për mos-raportim të të dhënave.

Për të rritur cilësinë e informacionit të publikuar si dhe krahasueshmërinë me periudhat e mëparshme, AKEP në disa raste përfshin vlerësimë të numrit të pajtimtarëve për operatorët (kryesish operatorë të vegjël të rrjeteve fiks) që nuk kanë raportuar në periudhën përkatëse duke përdorur numrin e pajtimtarëve të raportuar në periudhat e mëparshme të këtyre operatorëve. Gjithashtu në disa raste AKEP mund të publikojë rishikim të treguesve të publikuar për periudhat e mëparshme për shkak të ndryshimeve të vlerësimeve dhe/ose metodologjisë së përdorur nga AKEP dhe/ose raportimeve të operatorëve. Të tillë raste evidentohen nëpërmjet shënimëve përkatëse të AKEP në publikimin më të fundit të të dhënave/informacionit të tregut.

Të dhënat dhe treguesit e publikuar në këtë raport janë për pesë tremujorët e fundit, si dhe të dhëna vjetore përvitin para-ardhës. Për periudhat më të hershme lexuesi mund t'i referohet publikimeve të mëparshme të AKEP. Norma e ndryshimit të një treguesi me tremujorin para-ardhës paraqitet si ‘**Ndryshimi Tremujor**’, ndërsa norma e ndryshimit në terma vjetorë (me të njëtin tremujor në vitin para-ardhës) paraqitet si ‘**Ndryshimi v-m-v**’.

Për shkak të rrumbullakimeve të vlerave në disa raste mund të ekzistojë një mospërputhje jomateriale ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për tregues të caktuar.

Në Tremujorin e katërt 2022 kanë raportuar rreth 189 sipërmarrës të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, ndërsa për Tremujorin e tretë 2022 kanë raportuar 194 sipërmarrës. AKEP dëshiron të falenderojë operatorët që kanë depozituar të dhëna për këtë raport dhe shpreson në bashkëpunimin e vazhdueshëm me të gjithë operatorët për procesin e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave statistikore të komunikimeve elektronike në të ardhmen.

AKEP mirëpret sugjerime për të përmirësuar procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave statistikore si dhe të publikimeve të AKEP, me qëllim plotësimin e interesit publik për të krijuar një treg të hapur dhe konkurrues të komunikimeve elektronike në Shqipëri, duke ruajtur njëkohësht konfidencialitetin e të dhënave të publikuar nga AKEP për të shmagur përdorimin e tyre në mënyrë antikonkurruese dhe me praktika tregtare jo të ndershme nga konkurrentët në treg.

Dokumenti në vijim përmban përshkrim të nivelit të treguesve kryesorë në Tremujorin IV 2022 (T4 2022) dhe krahasime me periudhat e mëparshme, dhe më pas paraqiten të dhënat statistikore në formë tabelare për shërbimet nga rrjetet celulare dhe nga rrjetet fiks, të shoqëruara dhe me disa shënimë për përshkrimin e treguesve dhe mënyrën e matjes së tyre.

II. Tendencat kryesore

- Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare sipas kartave SIM në fund të T4 2022 ishte rreth 3,771,419 që përbën një rritje me 1.8% në krahasim me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 8.2% në krahasim me T4 2021;
- Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare gjatë T4 2022 arriti në rreth 2.7 milionë që përbën një rënie me rreth 5% me T3 2022 dhe rritje me rreth 5.3% me T4 2021;
- Numri i përdoruesve aktivë të aksesit broadband në Internet nga rrjetet celulare në T4 2022 ishte rreth 2.1 milionë që përbën një rënie 8.8% me tremujorin e mëparshëm, dhe një rritje me 4.1% në krahasim me Tremujorin e katërt 2021.
- Totali thirrjeve dalëse të gjeneruara nga pajtimtarët celularë në Shqipëri në T4 2022 ishte rreth 1.24 miliardë minuta, me një rënie prej 3.8% në krahasim me tremujorin paraardhës dhe me një rënie prej 8.4% me T4 2021.
 - o Sasia e thirrjeve drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (off-net) pësoi rënie me 7% në krahasim me T3 2022 dhe rënie me 13.3% në krahasim me një vit më parë në T4 2021;
 - o Sasia e thirrjeve on-net pësoi rënie me 1.3% në krahasim me T3 2022 dhe pësoi një rënie me 4.8% në krahasim me T4 2021.
 - o Proporcioni i thirrjeve on-net/off-net në T4 2022 ishte 58%/41%, kundrejt 56%/43% në T4 2021.
- Numri i mesazheve SMS të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare në T4 2022 ishte rreth 122 milion që përbën një rënie me 9.7% krahasuar me T3 2022 dhe një rënie me 12.8% me T4 2021;
- Sasia e trafikut data (Internet) në rrjetet celulare gjatë T4 2022 ishte rreth 40 Milion GByte. Një përdorues aktiv i aksesit broadband celular ka përdorur mesatarisht rreth 6.32 GB Internet në muaj në T4 2022, që përbën një rënie me 14.4% në krahasim me T3 2022 dhe një rënie me 7% krahasuar me T4 2021.
- Konsumi mesatar mujor për përdorues aktiv i shërbimeve celulare gjatë T4 2022 ishte: 150 minuta dalëse, 15 SMS dhe 6.32 GB Internet. Krahasuar me T3 2022, konsumi mesatar i thirrjeve pati një rritje me 1.2%, konsumi mesatar i SMS-ve pati një rënie me 5% dhe konsumi mesatar i internetit pësoi rënie me 14.4%.

Shërbimet nga rrjetet fikse

1. Numri i pajtimtarëve të linjave të telefonisë fikse në fund të tremujorit të katërt 2022 është raportuar rreth 177 mijë, që përbën një rënie me 0.6% në krahasim me T3 2022 dhe një rënie me 10.2% në krahasim me T4 2021.
2. Numri i pajtimtarëve më akses Broadband në internet nga rrjete fikse në T4 2022 arriti në rreth 582 mijë, që përbën një rritje me 2.4% në krahasim me tremujorin e mëparshëm dhe një rritje me rreth 8.5% në krahasim me të njëtin tremujor në vitin 2021.
3. Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni/Internet/TV) në fund të 3 mujorit të katërt 2022 arriti në rreth 306 mijë, një rritje kjo me 2.1% në krahasim me T3 2022 dhe rritje me 2.2% krahasuar me T4 2021.
4. Numri i pajtimtarëve me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV) përbën 23.6% të totalit të pajtimtarëve me paketa të integruara ndërsa 29.5% janë me paketa “Internet dhe Telefon” dhe 46.9% me paketa “Internet dhe TV”.
5. 53% e pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse në fund të T4 2022 ishin pajtimtarë me paketa të integruara (Telefoni/Internet/TV), ku 12% janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

III. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet celulare

Tabela 3.1 : Numri i pajtimtarëve/përdoruesve celularë sipas kategorive

	Numri i pajtimtarëve shërbime celularë	Përdorues aktivë shërbime celularë	Përdorues aktivë Telefoni Celulare	Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	Përdorues aktivë me akses broadband cellular	Përdorues me akses broadband telefoni celularë	Përdorues me akses broadband me karta të dedikuara
2020	3,337,824	2,618,880	2,508,230	77.0%	1,998,579	1,894,483	104,096
2021 T4	3,484,158	2,635,466	2,617,561	72.0%	2,056,444	2,038,539	17,905
2022 T1	3,416,311	2,599,579	2,580,174	70.0%	2,055,074	2,035,669	19,405
2022 T2	3,440,948	2,633,253	2,610,852	68.2%	2,101,338	2,078,937	22,401
2022 T3	3,703,690	2,923,471	2,898,946	70.2%	2,347,871	2,323,346	24,525
2022 T4	3,771,419	2,782,226	2,755,305	67.8%	2,140,180	2,113,259	26,921
Ndryshimi tremujor	1.8%	-4.8%	-5.0%	-3.4%	-8.8%	-9.0%	9.8%
Ndryshim v-m-v	8.2%	5.6%	5.3%	-5.8%	4.1%	3.7%	50.4%

Shënime:

Treguesi	Referenca ne Formulare/Menyra e llogaritjes	Pershkrim/Sqarim
Numri i pajtimtarëve shërbime celularë (karta SIM)	D.10	<p>Numri total i kartave SIM me parapagim dhe pas-pagim që janë aktivë në rrjetin celular në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse kanë kryer komunikim apo jo gjate periudhës së raportimit. Treguesi përfshin të gjitha kartat SIM që perdoren për shërbime zanore dhe të dhenash, të instaluarë në aparate celularë, modem, USB apo pajisje te tjera. Nuk përfshihen kartat M2M.</p> <p><i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të pajtimtareve të shërbimeve telefonike celularë + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i></p>
Përdorues aktive Shërbime Celulare	D.7	<p>Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve celularë në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim në 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celularë me karta SIM dhe karta të dedikuara të dhenash (Data Card).</p> <p><i>Per periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP si shumë e numrit total të përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celularë + numri i përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara.</i></p>
Përdorues aktive Telefonë Celulare	D.7-D.10.2	<p>Numri total i përdoruesve aktivë të shërbimeve telefonike celularë në fund të periudhës së raportimit. Përfshihen përdoruesit me parapagim aktivë (komunikim ne 3 muajt e fundit) dhe përdoruesit me paspagim (pavarësisht komunikimit ose jo në 3 muajt e fundit). Në këtë zë përfshihen përdoruesit e shërbimeve celularë me karta SIM telefonike. Nuk përfshihen Data Card.</p> <p><i>Për T4 2016 dhe T2 2017, treguesi është llogaritur nga AKEP si diferenca e D7 me numrin e përdoruesve akses broadband me karta të dedikuara (D.10.2).</i></p>
Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim	D.7.1/D.7	Numri i përdoruesve aktivë (përdorim në tre muajt e fundit) që përdorin karta rimbushëse përmes përdorimin e shëerbimit celular pjestuar me nurmin total të përdoruesve aktivë (D.7.1/D7).

		<i>Për periudhat para T4 2016, treguesi është llogaritur nga AKEP bazuar në numrin e përdoruesve aktivë të telefonisë celulare.</i>
Përdorues active të Akses Broadband Celular	D.10	Numri i pajtimtarëve në rrjetet celulare që kanë përdorur aksesin në Internet me shpejtësi broadband mbi 256 kbps (3G/4G ose me të avancuar) të paktën një herë gjatë periudhës së raportimit. Ky tregues ka kategorinë e përdorimit sipas aparatit telefonik celular, tableta etj me karta SIM (zanore dhe të dhëna) dhe nëpërmjet aksesit me karta SIM të dedikuara për të dhena (USB, dongles etj).
Përdorues akses broadband celular dhe telefoni celular	D.10.1	Numri i pajtimtarëve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin në Internet në rrjet 3G/4G ose më të avancuar nëpërmjet kartave SIM të telefonit cellular.
Përdorues akses broadband me karta te dedikuara (Data Card)	D.10.2	Numri i pajtimtareve të rrjetit që kanë përdorur aksesin në intenet, në rrjet 3G/4G ose më të avancuar, nëpermjet kartave të dedikuara për të dhëna (DATA CARD të dedikuara)

Tabela 3.2: Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celularë (karta SIM) sipas operatorëve

Numri i pajtimtarëve të shërbimeve celularë (karta SIM) sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom
2020	3,337,824	1,231,169	1,571,022	535,633
2021 T4	3,484,158	1,402,918	1,536,910	544,330
2022 T1	3,416,311	1,360,630	1,524,431	531,250
2022 T2	3,440,948	1,356,546	1,568,176	516,226
2022 T3	3,703,690	1,465,633	1,741,807	496,250
2022 T4	3,771,419	1,431,456	1,859,779	480,184
Ndryshimi tremujor	1.8%	-2.3%	6.8%	-3.2%
Ndryshim v-m-v	8.2%	2.0%	21.0%	-11.8%

Tabela 3.3: Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celularare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celularare sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom
2020	2,618,880	967,807	1,229,632	421,441
2021 T4	2,635,466	1,039,417	1,190,938	405,111
2022 T1	2,599,579	1,037,076	1,171,000	391,503
2022 T2	2,633,253	1,050,182	1,202,317	380,754
2022 T3	2,923,471	1,138,707	1,401,132	383,632
2022 T4	2,782,226	1,113,381	1,311,256	357,589
Ndryshimi tremujor	-4.8%	-2.2%	-6.4%	-6.8%
Ndryshim v-m-v	5.6%	7.1%	10.1%	-11.7%

TABELA 3.3/1: Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim të shërbimeve celulare sipas operatorëve

Përqindja e përdoruesve aktivë me parapagim sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom
2020	77.343	82.615	72.886	78.242
2021 T4	72.047	77.728	66.020	75.187
2022 T1	69.659	75.502	63.199	73.505
2022 T2	68.248	73.923	61.897	72.652
2022 T3	70.228	74.477	66.165	72.458
2022 T4	67.888	74.109	62.068	69.864
Ndryshimi tremujor	-2.340	-0.368	-4.097	-2.594
Ndryshim v-m-v	-4.159	-3.619	-3.952	-5.323

Tabela 3.4: Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve

Numri i përdoruesve aktivë të telefonisë celulare sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom
2020	2,508,230	873,499	1,219,419	415,312
2021 T4	2,617,561	1,032,085	1,185,435	400,041
2022 T1	2,580,174	1,028,234	1,165,184	386,756
2022 T2	2,610,852	1,039,757	1,195,528	375,567
2022 T3	2,898,946	1,126,723	1,393,075	379,148
2022 T4	2,755,305	1,099,314	1,303,729	352,262
Ndryshimi tremujor	-5.0%	-2.4%	-6.4%	-7.1%
Ndryshim v-m-v	5.3%	6.5%	10.0%	-11.9%

Tabela 3.5: Numri i përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve

Numri përdoruesve të akses broadband në rrjetet 3G/4G sipas operatorëve	Total	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom
2020	1,998,579	718,631	981,483	298,465
2021 T4	2,056,444	825,707	925,967	304,770
2022 T1	2,055,074	850,431	909,449	295,194
2022 T2	2,101,338	867,352	947,151	286,835
2022 T3	2,347,871	901,463	1,151,969	294,439
2022 T4	2,140,180	836,931	1,033,888	269,361
Ndryshimi tremujor	-8.8%	-7.2%	-10.3%	-8.5%
Ndryshim v-m-v	4.1%	1.4%	11.7%	-11.6%

Tabela 3.6: Volumi total i thirrjeve, SMS-ve, të dhëna dhe përdorimi mesatar mujor

	Totali i thirrjeve telefonike dalese	SMS të dërguara	Trafiku të dhëna (Gbyte)	Minuta në muaj për përdorues	SMS në muaj për përdorues	GB në muaj për përdorues
2020	5,321,923,358	660,604,925	88,950,833	168	30	3.90
2021 T4	1,356,447,837	139,915,226	41,953,050	173	18	6.80
2022 T1	1,259,590,545	128,704,389	44,537,698	163	17	7.22
2022 T2	1,307,362,306	134,282,261	48,976,958	167	17	7.77
2022 T3	1,291,063,691	135,212,665	52,046,842	148	16	7.39
2022 T4	1,241,993,435	122,046,156	40,593,109	150	15	6.32
Ndryshimi tremujor	-3.8%	-9.7%	-22.0%	1.2%	-5.0%	-14.4%
Ndryshim v-m-v	-8.4%	-12.8%	-3.2%	-13.0%	-17.1%	-7.0%

Shënime:

Treguesi	Referenca në Formulare/Mënyra e llogaritjes	Përshkrim/Sqarim
Thirrje telefonike dalëse	D.11	<p>Thirrje telefonike dalëse të kryera nga pajtimtaret e rrjeteve celulare gjatë periudhës së raportimit. Trafiku i përfshirë në pagesa fikse llogarit minutat e kryera (reale) dhe jo vlerat nominale të ofertave/shportave. Ky tregues nuk përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trafikun e pajtimtrëve të rrjeteve celulare Shqiptare gjatë kohës që ata janë në roaming ndërkombëtar. - Trafikun e pajtimtarëve të rrjeteve të huaja gjatë kohës që ata janë ne roaming në rrjetet celulare Shqiptare.
SMS të dërguara	D.13	Numri total i SMS-ve të dërguara nga pajtimtarët e rrjeteve celulare drejt të gjitha destinacioneve, përfshirë SMS ndërkombëtare
Trafiku të dhëna (GByte)	D.14	<p>I referohet sasisë së trafikut broadband të origjinuar brenda Shqipërisë nga rrjetet celulare 3G/4G ose me të avancuara. Trafiku përfshin shkarkimet dhe ngarkimet (download dhe upload) i matur në pikat e aksesit të përdoruesit fundor. Nuk përfshihet trafiku me shumicë dhe 'ealled garden'.</p> <p><i>Në bazë tremujore ky tregues është i ditsonueshëm vetëm për T4 2016, T12017 e në vijim. Më parë është raportuar vetëm në bazë vjetore.</i></p>
Minuta në muaj për përdorues	D.11/(D.7-D.10.2)/3	Numri i minutave të thirrjeve dalëse që një përdorues aktiv i shërbimeve telefonike celulare ka gjeneruar mesatarisht në një muaj. Llogaritet si rapporti i trafikut total dalës (D7) me numrin e përdoruesve aktive të telefonisë celulare (D.7-D.10.2) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktívë në fillim dhe në fund të periudhës.
GB në muaj për përdorues	D.14/D.10/3	Sasia GB e trafikut të Internetit që një përdorues aktiv i shërbimeve akses broadband celular ka përdorur mesatarisht në një muaj. Llogaritet si rapporti i trafikut total të të dhënave (D14) me numrin e përdoruesve aktive të aksesit broadband celular (D.10) dhe rezultati pjestohet me 3. Në treguesit në bazë vjetore përdoret numri mesatar i përdoruesve aktívë në fillim dhe në fund të periudhës.

Tabela 3.7: Struktura e thirrjeve dalëse celulare të origjinuar brenda vendit sipa destinacionit

Struktura e thirrjeve dalëse celulare	Total	On-net	Off-net	Fiks kombëtar	Ndërkombe	Të tjera
2020	5,321,923,358	2,982,390,253	2,245,834,166	58,137,508	31,517,660	4,043,770
2021 T4	1,356,447,837	752,993,954	581,598,948	12,220,339	8,801,192	833,404
2022 T1	1,259,590,545	707,765,253	531,987,548	11,093,922	7,951,950	791,871
2022 T2	1,307,362,306	740,037,288	546,393,618	10,929,552	9,177,480	824,369
2022 T3	1,291,063,691	726,326,355	541,865,033	10,805,457	11,165,713	901,133
2022 T4	1,241,993,435	716,668,347	504,096,617	10,029,753	8,665,711	2,533,007
Ndryshimi tremujor	-3.8%	-1.3%	-7.0%	-7.2%	-22.4%	181.1%
Ndryshim v-m-v	-8.4%	-4.8%	-13.3%	-17.9%	-1.5%	203.9%

IV. Treguesit e tregut të shërbimeve nga rrjetet fikse

Tabela 4.1 : Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse

Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fikse	Totali	Albtelecom	ASC	Vodafone	Abissnet	Nisatel	OA të tjera	Pjese tregu Albtelecom
2020	223,469	168,142	30,399	8,524	4,154	4,122	8,128	75.2%
2021 T4	197,324	152,829	20,583	8,355	4,191	4,164	7,202	77.5%
2022 T1	186,718	147,301	16,569	8,260	4,185	4,160	6,243	78.9%
2022 T2	182,873	145,720	14,059	7,897	4,197	4,160	6,840	79.7%
2022 T3	178,227	142,722	12,218	7,757	4,210	4,144	7,176	80.1%
2022 T4	177,152	143,150	11,804	7,726	4,231	4,121	6,120	80.8%
Ndryshimi tremujor	-0.6%	0.3%	-3.4%	-0.4%	0.5%	-0.6%	-14.7%	0.9%
Ndryshim v-m-v	-10.2%	-6.3%	-42.7%	-7.5%	1.0%	-1.0%	-15.0%	4.3%

Tabela 4.2 : Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse¹

Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjete fikse	Totali	Albtelecom	Vodafone	ASC	Abissnet	Digicom	Nisatel	I.B.C	Fastnet Albania	OA të tjera
2020	508,937	128,877	95,558	58,529	41,576	22,400	17,609	6,600	2,000	135,788
2021 T4	536,474	118,130	111,072	59,275	42,338	24,850	20,586	11,565	N/A	148,658
2022 T1	523,108	114,676	113,184	58,682	42,491	25,300	21,055	11,898	N/A	135,822
2022 T2	535,558	113,876	122,036	55,947	42,684	25,503	21,501	10,801	9,000	134,210
2022 T3	568,208 ²	112,273	126,894	52,595	42,938	25,700	22,361	9,402	9,000	167,045
2022 T4	582,035	113,197	126,115	60,282	43,175	27,097	22,386	9,410	9,050	171,323
Ndryshimi tremujor	2.4%	0.8%	-0.6%	14.6%	0.6%	5.4%	0.1%	0.1%	0.6%	2.6%
Ndryshim v-m-v	8.5%	-4.2%	13.5%	1.7%	2.0%	9.0%	8.7%	-18.6%	N/A	15.2%

¹ Në këtë tabelë janë paraqitur operatorët me mbi 9,000 pajtimtar me akses broadband nga rrjetet fikse

² Përditësuar të dhënat mbi numrin e pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fikse për T3 2022

Tabela 4.3 : Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara

Numri i pajtimtarave që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	Totali	Telefoni fiks dhe Internet	Telefoni fiks, Internet dhe TV	Internet dhe TV
2020	294,587	89,953	102,870	101,764
2021 T4	300,347	82,642	91,689	126,016
2022 T1	288,961	79,061	91,069	118,831
2022 T2	290,870	87,231	81,217	122,422
2022 T3	300,603	88,024	76,919	135,660
2022 T4	306,866	90,584	72,485	143,797
Ndryshimi tremujor	2.1%	2.9%	-5.8%	6.0%
Ndryshim v-m-v	2.2%	9.6%	-20.9%	14.1%

Shënim:

Treguesi	Referencia në Formulare/Menyra e llogaritjes	Përshkrim/Sqarim
Numri i linjave të pajtimtarëve të telefonisë fiksë	A.1	<p>Ky tregues i referohet numrit total të linjave telefonike që pajtimtarët e rrjetit fiks përdorin për shërbim telefonik fiks dhe që plotësojnë dy kushte: 1) pajtimtarit i është alokuar një numër fiks në rrjetin e operatorit (përfshirë numrat e marrë nga operatorët e tjera me portim), dhe 2) numri fiks i alokuar është në perdonim në fund të periudhës së raportimit, pavarësisht nëse është kryer apo jo thirje (dalëse apo hyrëse) gjatë periudhës nga pajtimtari. Pra ky tregues është sasia totale e numrave fiks të alokuar dhe që janë ende në përdorim nga pajtimtarët në fund të periudhës së raportimit. Këtu përfshihen edhe pajtimtarët që kanë të përfshirë shërbimin e telefonisë fiksë si pjesë e paketave të integruara së bashku me shërbime të tjera si Internet, TV etj.</p> <p>Për periudhën 2014 T4- 2015 T3 ky tregues përfshinte totalin e pajtimtarëve me parapagim të telefonisë fiksë (numri i pajtimtarëve aktivë, pra që kanë përdorur shërbimin e telefonisë fiksë në 3 muajt e fundit, të paktën një thirje hyrëse ose dalëse) dhe pajtimtarët me kontratë/paspagim ose me parapagim por që kanë paguar në avancë shërbimin (për tre muajt e fundit) të cilët konsiderohen aktivë.</p> <p>Për shkak te ndryshimit të përkufizimit në T4 2016, për të mundësuar kruhasueshmërinë e vlerave të këtij treguesi në periudha të ndryshme kohore (parimi i rregullores se statististikave ne pikën 6.2), AKEP ka kryer vleresim të këtij treguesi për periudhat para T4 2016 për përfshirje në këtë tregues të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fiksë, pavarësisht përdorimit aktiv (në 3 muajt e fundit) ose jo, sic ishte përkufizimi në 2014 T4- 2016 T3. Per me shume shiko shenimin poshtë Tabelës 4.1.</p>
Numri i pajtimtarëve me akses broadband nga rrjetet fiksë	B.1	<p>Përfshin numrin total të pajtimtarave me akses broadband fiks me shpejtësi download 256 kbit/s ose më të madhe. Ky tregues përfshin aksesin në internet me DSL, modem kabllor, fibër në shtëpi/ndërtese dhe gjithë llojet e tjera të aksesit broadband me rrjet fiks. Nuk përfshihet aksesi broadband me rrjet celular. Totali i pajtimtarëve llogaritet pavarësisht nga metoda e pagesës. Përfshin WIMAX fiks dhe çdo teknologji tjetër wireless fiksë.</p>

		Ky tregues i referohet numrit total te abonentëve aktive të internetit që përdorin rrjetin fiks. Qëllimi i këtij treguesi është abonenti aktiv, pra nëse atyre nuk ju gjenerohet një faturë mujore, vetem ata abonentë që kanë përdorur internetin apo janë lidhur me Internet të paktën një herë gjate 3 muajve të fundit duhet të numërohen. Nga ana tjeter, të gjithë pajtimtarëve që ju gjenerohet një faturë mujore duhet të numërohen si aktivë. Përfshtin pajtimtarët që përdorin aksesin broadband për përdorim familjar dhe për biznes.
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruese (Telefoni, Internet dhe TV)	B.7	Numri total i pajtimtarëve që kanë paketa të përbashkëta (të integruar-bundles) sipas kombinimeve te mëposhtme. Paketa të integruese konsiderohen kur paguajnë një tarifë fikse që përfshin të paktën 2 shërbime: Telefon, Internet apo TV.
Telefoni fiks dhe Internet	B.7.1	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të përbashkët (dyfishe) telefoni dhe internet (pakete dyfishe), duke paguar një tarifë që përfshin dhe pajtimin mujor për telefonin dhe për aksesin në Internet broadband. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin telefonin dhe Internet por që kanë tarifa të vecanta mujore për dy shërbimet. Pagesa fikse mund të perfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit.
Telefoni fiks, Internet dhe TV	B.7.2	Numri i pajtimtarëve të rrjetit fiks që kanë paketë të perbashket (trefishe) telefoni, Internet dhe TV (IPTV ose TV kabllor), duke paguar një tarifë që përfshin pajtimin mujor për telefonin, aksesin në Internet broadband dhe kanalet TV. Nuk përfshihen pajtimtarët që përdorin tre shërbimet por që kane tarifa të vecanta mujore për tre shërbimet. Pagesa fikse mund të përfshijë ose jo minuta thirrje (falas) dhe Interneti mund të jetë me limit ose pa limit, si dhe kur ka pagesë ekstra për kanale TV shtesë mbi kanalet bazë TV.
Internet dhe TV	B.7.3	Pajtimtarë të rrjeteve fikse që kanë vetëm Internet dhe TV, pra jo telefonin fikse.